



VENDIM

Nr. 7, Datë 15.05 2015

Për ecurine ekonomike per periudhen Janar-Prill 2015 dhe situatën financiare të UART per vitin 2015

Senati i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e tij të hapur të datës 15.05.2015, pasi dëgjoi materialin e hartuar nga Kancelari dhe paraqitur nga Rektori "Për ecurine ekonomike per periudhen Janar-Prill 2015 dhe situatën financiare të UART per vitin 2015", duke vlerësuar menaxhimin e burimeve financiare në dispozicion të Universitetit të Arteve, bazuar në nenin 14, pika 2, germa ç, të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", i ndryshuar,

VENDOSI

1. Miratimin e veprimtarise ekonomike te Universitetit të Arteve për periudhen Janar-Prill 2015
2. Shpenzimet e parashikuara për vitin 2015 për "Paga"(art.600) dhe "Sigurime shoqërore dhe Shëndetsore"(art.601) nuk mund të reduktohen, mbasi janë të domosdoshme për sigurimin e ecurisë së veprimtarisë së Universitetit të Arteve.
3. Shpenzimet e parashikuara për vitin 2015 për "Mallra dhe shërbime"(art.602) nuk mund të reduktohen, përkundrazi, mbasi ato nuk përfshijnë në mënyrë të plotë kërkesat për bazën mësimore materiale për mesimdhënie.
4. Duke parë pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve të parashikuara me vitin 2015, me buxhetin aktual, të cilin Univesiteti i Arteve ka në dispozicion, Rektorati ti drejtohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për mundësinë e akordimit të një granti shtesë për vitin 2015.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Petrit MALAJ

Prof.Dr. Zana SHUTERIQI

Prof. Asoc. Artan PEQINI

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Gazmend LEKA

Prof. Asoc. Haig ZACHARIAN

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Ilir MARTINI